



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 320, Datë 12.12.2022

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALBSOLAR” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK
“ALBSOLAR PV PARK 1”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 MW**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2 gërma “a” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “a”, nenit 5, pika 1 gërma “a”, nenit 13 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 12.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2039/5prot., datë 07.12.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë “ALBSOLAR” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Albsolar PV Park 1”, me kapacitet të instaluar 2 MW, në Bisht Kamëz, Bashkia Durrës”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 293, datë 10.11.2022 vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “ALBSOLAR” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Albsolar PV Park 1”, me kapacitet të instaluar 2 MW.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 12.11.2022 dhe 14.11.2022) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 21.11.2022), nuk rezultoi të ketë të tilla.
- Me shkresën nr. 1874/4 prot., datë 18.11.2022, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe duke i kërkuar dokumentacionin e konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht.

- Po ashtu me shkresën nr. 1874/3 prot., datë 17.11.2022 ERE i është drejtuar edhe MIE-s duke i kërkuar që brenda 10 ditëve nga marrja dijani e shkresës të japë qëndrimin e saj mbi sa vendosur nga Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive në vendimin e datës 08.11.2022, që licenca e prodhimit t'i lëshohet shoqërisë ALBSOLAR sh.p.k. Deri më sot nuk rezulton të jetë përcjellë në ERE qëndrimi i MIE-s për sa kërkuar, ndaj vlerësohet vijimi me vendimmarrjen përfundimtare të ERE-s për sa shprehur nga Bashkimi i shoqërive me vullnet të lirë, duke lënë mundësinë e rishikimit të vendimit të licencimit në rast se MIE do të shpreh qëndrimin e saj.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e prodhimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.1); Shtojcën 1, Shtojcën 1A dhe Shtojcën 2 të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi (Aneksi A).
- Aplikuesi ka kryer për llogari të ERE-s pagesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, referuar Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar.
- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “ALBSOLAR” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin si në zbatim të rregullores për nenin 9, pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 2.1, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.
- ERE, në zbatim të nenit 38 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet, por duke qenë se nga se deklaruar nga shoqëria rezulton se jetëgjatësia e pritshme e centralit fotovoltaikështë 25 vjet, atëherë ERE kushtëzohet nga kjo jetëgjatësi në dhënien e afatit maksimal për këtë licencë fotovoltaike, deri në 25 vjet.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “ALBSOLAR” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik “Albsolar Pv Park 1, me kapacitet të instaluar 2 MW për një afat 25 – vjeçar,
2. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në vijim të qëndrimit të MIE-s për sa vendosur nga Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive në vendimin e datës 08.11.2022, që licenca e prodhimit t’i lëshohet shoqërisë “ALBSOLAR” sh.p.k.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR

Petrit AHMETI

